

PROCES-VERBAL

I mbajtur sot me datë 13.11.2017, në sallën e Bibliotekës Nr.2, Rruga “Tefta Tashko Koco”.
Marrin pjesë në këtë takim qytetar nga e gjithë Njësia Administrative nr.2, Bashkia Tiranë.

I deleguar nga Bashkia Tiranë z.Erindi Bejko Drejtor i Pergjithshëm OBANJAEC.

Rendi i Dites : DËGJESË PËR BUXHETIN 2018 PËR NJ.ADM.NR.2

Elez GJOZA, Administrator i Njesisë Administrative Nr.2, pas fjalës se tij të hapjes dhe përshëndetjes, u shpreh:

“Njësia jone ka numrin me të madhë të banoreve në Tiranë dhe zë një sipërfaqe rreth 1/5 e gjithë sipërfaqes së territorit të Tiranës, dhe kjo na bën të presim shumë qytetare në takime të ndryshme për të degjuar shqetësime dhe problemet që ata kanë në Njësine Administrative Nr.2.

Nga ana ime në çdo takim që kam zhvilluar me qytetaret, i kam informuar mbi punën dhe projektet e Bashkisë Tiranë për Njësine.

Dhe konkretisht për njësine nr.2 janë realizuar, Faza e parë e bllokut 41, 42; Pazari i Ri, Rruga “Herman Gmenier”, Shkolla “Hasan Tahsim”, Tregu Fruta-Perime Rruga Petro Nini Luarsi”, Sheshi Skenderbej, etj.

Janë duke perfunduar punimet në bllokun 68 pranë Ambasadës Amerikane, dhe në Rrugën Faik Konica.

Nga ana jone në vazhdimësi të bashkëpunimit me Bashkinë e Tiranës, është kerkuar dhe rakorduar me Drejtorinë e Puneve Publike fillimin e punimeve për fazën e II-te të blloqeve 41, 42; Fillimi i punimeve në bllokun 64.

Nga ana e Njesisë Administrative Nr.2 ju sugjerua të merren në konsideratë si dhe:

1. Zgjerimi i seksionit në segmentin e fillimit të kolektorit “Perroi Gogëve” në Rrugën Haki Gjici;
2. Mundësia e nderhyrjes në degezin e këtij përroi (bëhet fjalë për kolektorin që përfshin edhe derdhjet e Senatoriumit, për faktin se një pjesë e tij kalon nëpër oborre banesash).
3. Kopeshti i Saukut të vjetër të kalojë nga kopesht me pa dreke në kopesht me dreke. Kjo është e mundur pasi kushtet aktuale e lejojnë këtë ndryshim i cili vjen edhe si një kërkesë e rëndësishme nga komuniteti përreth saj.
4. Kërkojmë zgjidhjen e problemit shumë serioz të shkolles “Sander Prosi” në Senatorium pasi oborri i kësaj shkolle përdoret edhe si kalim për mjetet motorrike, çka përbenë rrezik potencial për aksidente.
5. Kërkojmë të ndricohet Rrugët “Todi Shkurti”, “Petro Nini Luarasi”, dhe nën kalimet e pallateve,

Njesia Administrative Nr.2 e shikon të frytshme dhe shume të sukseshme bashkepunimin me Bashkine e Tiranes si dhe perkushtimin e Kryetarit të Bashkise z.Erion Veliaj për realizimin dhe transformimin e Tiranes në një qytet modern. Jemi në mbeshtetje për realizimin e të gjithë programit që parashikohen të realizohen.